



REMUSICA

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS

17-25 MAJ

2008



Remusica do të mbahet në shenjë të 100 vjetorit të lindjes së kompozitorit **Olivier Messiaen**

Remusica në këtë edicion shënon 65 vjetorin e lindjes së kompozitorit **Zeqirja Ballata** dhe 50 vjetorin e lindjes së kompozitorit **Mendi Mengjiqi**



Editorial

Komunikimi me modernën evropiane mbetet edhe më tutje prioritet i 'Remusica'. Në këtë rrugë të zgjedhur të saj, shtrohen dy detyra madhore për krijuesit tanë: avancimi i gjuhës shprehëse të tyre, ruajtja dhe kultivimi i veçorive dalluese të universit tingëllor autokton kosovar (shqiptar). Derisa vitin e kaluar, kompozitorët e rëndësishëm evropian si Michael Finnissy, Giovanni Mancuso dhe Velimir Zaimov, shkruan vepra të bazuar në polifoninë shqiptare, sivjet 'Remusica' ka marr një iniciativë tjetër: ka bërë porosinë për kompozimin e veprave origjinale moderne nga disa autorë kosovarë duke shfrytëzuar jo vetëm tingëllimin e folklorit tonë, por edhe instrumentet tona autoktone popullore. Premiera e këtyre veprave do të jetë në koncertet e datës 17 dhe 24 maj.

Element tjetër i edicionit të sivjemë është plotësimi i synimit themelor të festivalit - afirmimi i krijimtarisë së kompozitorëve kosovarë të të gjitha gjeneratave. Do të dëgjojmë krijimet më të reja të kompozitorëve të rinj dhe të gjeneratës së mesme. Por në 'Remusica' do të dëgjojmë edhe veprat e doajenëve të muzikës sonë si ato të kompozitorit Rexho Mulliqi me çka do ta kujtojmë atë (në 25 vjetorin e vdekjes së autorit) me një ngjarje të rëndësishme për kulturën tonë - do të ekzekutohet vepra Simfonia nr.1 e shkruar 50 vjetë më parë, partitura e se cilës deri më tash është konsideruar e humbur.

Edicioni i sivjemë i "Remusica-s" do të mbahet në shenjë të 100 vjetorit të lindjes së kompozitorit të madh francez, kolosit të muzikës së shekullit XX-të, Olivier Messiaen. Do të realizohen disa vepra të këtij autori, por do të ketë edhe një Tribunë të veçantë për veprën e tij. Gjithashtu 'Remusica' në këtë edicion shënon 65 vjetorin e lindjes së kompozitorit Zeqirja Ballata dhe 50 vjetorin e lindjes së kompozitorit Mendi Mengjiqi me realizimin e një numri të konsiderueshëm të veprave të tyre dhe me aktivitete të tjera.

Në fund duhet të shprehim falenderim të theksuar për ata që ndihmuan Festivalin 'Remusica' dhe të cilët pandërprerë kanë pasur besim në të: KFOS-in, Ambasadën franceze, Ambasadën gjermane, Forumin kulturor austriak, Goethe Institute, Proreklam, shtëpitë tona televizive, Kuvendin Komunal të Prishtinës dhe Ministrinë e Kulturës, nën patronatin e së cilës mbahet Festivali që nga fillimi i tij.

Rafet Rudi, kompozitor



**Fjala e Ministrit të Kulturës
z. Valton BEQIRI
në hapje të Festivalit
Ndërkombëtar të Muzikës së Re
REMUSICA 2008**

Miq të nderuar,

Pas këtyre nëntë viteve të një realiteti të ri në Kosovë, ngadal por sigurt është duke u profiluar skena kulturore e Kosovës. Gjithsesi festivalet e muzikës klasike, siq është REMUSICA, bëjnë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e këtij ambienti pozitiv kulturor.

Në këtë kohë, kur Kosova ka nevojë që të forcojë dhe pasurojë identitetin e vet, ajo do të kërkojë mbështetje në të gjitha fushat. Jam i bindur që, në përpjekje të forcimit të këtij identiteti, kultura do të ketë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe për shumë arsye të pazëvendë-sueshëm. Besoj se veçoritë më thelbësore dhe më autentike të këtij vendi janë të artikuluar pikërisht në art dhe në kulturë. Pasuritë materiale dhe shpirtërore të ndërtuara në këtë trevë, trashëgëmia e lashtë e mbetur e këtij populli, ndër të cilat shquhet muzika, është mbështetja jonë më e mirë në arsyeshmërinë e zgjedhjes së kësaj rruge. Emrat si Niketë Dardani (nga shekulli IV), Jan Kukuzeli, Filip Pjetër Drishti, pastaj Fan Noli e të tjerë na japin të drejtën për rrugën e zgjedhur. Pikërisht për këtë arsye, kultura duhet të ketë vend të rëndësishëm në planifikimet tona strategjike.

Manifestimin ndërkombëtar REMUSICA, si dhe manifestimet e ngjashme, në të cilin në mënyrë reprezentative prezantohet krijimtaria e kompozitorëve dhe arti i krijuesve tanë në një konkurrencë të tillë të lartë të nivelit dhe karakterit evropian do ta përkrahim me bindjen tonë të thellë se rruga jonë drejt Evropës dhe kthimi i ynë i madh në gjirin e saj, në gjirin evropian do të jetë më i shkurtër dhe më i qetë.

Prishtinë, 17 maj 2008



19:30

Hapja Festivalit / Salla e Kuqe - Prishtinë /
Koncert “Muzika tradicionale - muzika moderne”
| Okteti+ | Shaqir Hoti - kavall (dhe instrumente popullore) |
| Valton Beqiri - piano | Percussion "SONANT" Mojca Sedeu, Patris Berisha,
Nesim Maxhuni |
| Valton Beqiri | Donika Rudi |

20:30

Koncert / Salla e Kuqe /
PIERROT LUNAIRE ENSEMBLE WIEN (Austri)
| Philippe Gaubert | Zeqirja Ballata | Klaus Lang |
| Olivier Messiaen | William J. Peltier | Isang Yun |

19:30

Recital / Kisha katolike “Shën Ndou“/
FLORIAN VLASHI, violinë (Spanjë)
| Olivier Messiaen | G.Ph. Teleman | Sergei Prokofiev | Aleksander Peçi | Zeqirja Ballata |
| Iannis Xenakis | Alfred Schnittke |

19:30

Koncert / Kisha katolike “Shën Ndou“/
JOHANNES FISCHER, perkusione (Gjermani)
| Eugene Ughetti | Vinko Globokar | Alvin Lucier | Anthony Pateras | Nicolaus A. Huber |
| Mendi Mengjiqi | Javier Alvarez |

12:00

Tribunë Muzikologjike / ART Qendër /
“Instrumentet karakteristike popullore shqiptare”
Prezentim i **Shaqir Hotit**

19:30

Koncert / Kisha katolike “Shën Ndou“/
KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS
Rafet Rudi, dirigjent
Adelina Thaqi - soprano, **Sanije Matoshi** - mexosoprano
Misbah Kaçamaku - piano, **Jeta Kaçamaku** - piano, **Bislim Muçaj**, recitator
| Oliver Messiaen | Johannes Brahms | Zoltan Kodaly | Velislav Zaimov |
| Mendi Mengjiqi | Franz Liszt | Rafet Rudi |



12:00

Tribunë Muzikologjike / ART Qendër /
a) “Disa akcente të opusit kamertal dhe vokalo-instrumental të Zeqirja Ballatës”
Referues: Dr.**Franc Kriznar**, muzikolog (Slloveni)
b) “Profil i kompozitorial i Mendi Mengjiqit”
Referues: **Zeqirja Ballata**

19:30

Koncert kamertal / Kisha katolike “Shën Ndou” /
Blerim Grubi - violë, **Elife Podvorica** soprano
Sihana Badivuku - violinë, **Lejla Pula** - piano
Lule Elezi - piano, **Zana Badivuku** - piano, **Pranvera Hoxha** - piano
| Alfred Schnittke | Esat Rizvanolli | Claude Debussy | Benjamin Britten |
| Luigi Cherubini | Tommaso Traetta | Maurice Ravel |

12:00

Tribunë Muzikologjike / ART Qendër /
Ligjëratë “MESSIAEN - “Réveil d’oiseau du XX éme siecle”
(Zgjimi i zogut të shekullit XX-të)
Referues: Dr.**Franc Kriznar**, muzikolog (Slloveni)

19:30

Koncert / Atriumi i Bibliotekës Kombëtare /
Kompozitorët dhe interpretët e rinj
Kuarteti Harkor (Shqipëri), Liudmila Ivanova (Bullgari), Ajet Çekiçi,
Ergys Pirani (Shqipëri), Kreshnik Aliçkaj (Kosovë),
Ognenka Gerasimovska (Maqedoni), Neritan Hysa, Lejla Beqiri (Maqedoni),
Okteti+, Riad Ymeri, Luan Durmishi, Zana Abazi
| Vinçenc Gjini | Fahri Beqiri | Valton Beqiri | Mendi Mengjiqi | Arvo Part |
| Sergei Prokofjev | Liudmila Ivanova | Gerard Meunier |

12:00

Tribunë Muzikologjike / Fakulteti i Arteve /
Debat: “Muzicimi – formë e dialogut ndërkulturor”
Marrin pjesë: Muzicientët e rinj nga Bosnja e Hercegovina, Bullgaria,
Shqipëria, Maqedonia, Kosova

19:30

FILHARMONIA E KOSOVËS / Salla e Kuqe /
Baki Jashari, dirigjent
Bostian Lipovsek, kornë (Slloveni)
| Zeqirja Ballata | W. A. Mozart | Rexho Mulliqi |

17 MAJ 2008
E SHTUNË

19:30 HAPJA / Pallati i Rinisë – Salla e Kuqe /

Koncert “Muzika tradicionale - muzika moderne”

Valton Beqiri

"Buka e hidhur" (Teksti: Eqrem Basha)

Donika Rudi

"Au delà du rêve" (Beyond the dream)

Okteti+

Shaqir Hoti, kavall (dhe instrumente popullore)

Valton Beqiri, piano

Percussion "Sonant"

Mojca Sedeu, Patris Berisha, Nesim Maxhuni

20:30 Koncert / Pallati i Rinisë – Salla e Kuqe /

Pierrot Lunaire Ensemble Wien (Austri)

Philippe Gaubert (France)

Deuxième Sonate

Pastorale/Andante/Assez vif

Zeqirja Ballata (Kosovo)

Fyelli I Martinit

Klaus Lang (Austria)

Der Tor, die Königin und der silberne Schuh

Olivier Messiaen (France)

Le Merle Noir

William J. Peltier (Canada)

Wintertime for Chapering in Basement

Isang Yun (South Korea)

Garak

The Pierrot Lunaire Ensemble Wien ®

The Pierrot Lunaire Ensemble Wien është një ansambël ndërkombëtarisht i njohur që u themelua nga flautistja Silvia Gelos dhe pianisti Gustavo Balanescu në mënyrë që t'i kundërvihen diskrepancës në mes të realitetit të jetës muzikore në një anë dhe ëndrrës së muziktarëve në anën tjetër. Qëllimi kryesor i këtij ansambli është të ofrojnë programe koncertale shumë të ndryshme për publikun dhe në të njëjtën kohë duke i zgjeruar njohuritë e tyre dhe të kuptuarit e koncerteve. Shumë tipike për këtë ansambël janë veprat inovative nga muzika programatike dhe struktura organizative e vetërregulluar e ansambilit. Kur Ansambli Pierrot Lunaire shfaq koncertet e tij ndërkombëtare ai ruan një pjesë të programit për të performuar vepra klasike të shekullit XX. Në mënyrë që të zhvillojnë këtë shkëmbim dhe të avancojnë më tutje punën e tyre përtej fazës së zbulimit, ata kanë qëllim më të largët që të zhvillojnë marrëdhënie kulturore. Ky ansambël bashkëpunon në mënyrë të rregullt me institucionet austriake dhe ndërkombëtare dhe kontribuon në gjetjen e veprave dhe ideve muzikore të kompozitorëve të rinj austriakë por edhe të atyre ndërkombëtar. Ansambli Pierrot Lunaire Wien prezenton muzikën bashkëkohore me rreth 50-60 koncerte në vit, në nivelin më të lartë të mundshëm artistik krahas stileve tashmë të konfirmuara në festivalet ndërkombëtare, koncertet e rëndësishme në hapësirat koncertale të njohura dhe krahas cikleve të tyre koncertale vetanake.

18 MAJ 2008

E DIË

19:30 **Recital** / Kisha Katolike “Shën Ndou” /

Florian Vlashi, violinë (Spanjë)

Georg Philip Telemann

Fantasie Nr.9

Siciliana, Vivace, Allegro

Sergei Prokofiev

Sonata për violinë solo D-major op.115 (1947)

Moderato, Tema me variazione, Con brio

Olivier Messiaen (në 100 vjetorin e lindjes)

Tema me variazione

Lejla Pula, piano

Aleksandër Peçi

Dea

Zeqirja Ballata

Glissandi

Iannis Xenakis

Mikka (1971)

Alfred Schnittke

A Paganini (1982)



Florian Vlashi, violinë

Florian Vlashi u lind në Durrës, Shqipëri (1963). Ai filloi studimet për violinë në moshën 6 vjeçare. Babai i tij shkrimtar dhe drejtor i njohur teatri, Gjergji Vlashi, pati rol të rëndësishëm në të ardhmën e djalit të tij. Ai studioi me violinistët e njohur V.Papa, R. Stefi, I. Madhi dhe fitoi Çmimin e parë na Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë. Më 1989, ai fitoi Çmimin e parë në Garat e Solistëve dhe të Orkestrës Simfonike të Shqipërisë. Ai poashtu ishte drejtues dhe solist i Orkestrës Harkore “Jan Kukuzeli” me të cilën performoi shumë koncerte dhe realizoi incizime për RTVSH, përfshirë edhe turneun koncertal në Itali. Që nga 1992, ka qenë anëtar i Orkestrit të Shtutgartit (OSG), ku studioi me G. Egger (Bachakademi Stuttgart) dhe me L. Müller (Concertino de la Orquesta de Camera de Viena). Aktiviteti i tij u zgjerua edhe me pedagogjinë muzikore, publikimet mbi interpretimin estetik dhe në kongrese. Ai është ftuar që të interpretojë në inaugurimin e sezonës koncertale në Qendrën e Artit Modern REINA SOFIA, Fondacionin JUAN MARCH, Auditorio Nacional de Música of Madrid, CAIM -Salamanca, CAI - Zaragoza, në Akademinë e Spanjës në Romë, Institutin Servantes në Napoli, Suiza etj. dhe në shumë festivale si në La Coruña, Santiago, Vigo, Bilbao, duke bashkëpunuar si solist me Ansamblin Plural të Madridit. Kompozitorët si E.Buharaja, C.López García, J.Vara, X.De Paz, P.Pereiro, D.Malumbres, J.Durán kan shkruar vepra enkas për të. Që nga 1996, ai ka drejtuar grupin kamertal Paganini Ensemble dhe Grupin Instrumental SIGLO XX, i cili është i formuar nga solistët e OSG-së që kan dhënë koncerte premierë më shumë se 30 vepra të kompozitorëve spanjollë, disa të porositur nga vetë grupi. Koncertet e tyre janë transmetuar nga Radio Clásica dhe Radio Nacional de España, TVE2 dhe nga Canal Internacional de España. F.Vlashi luan në një violinë franceze të shekullit 18-të të punuar nga J.Bocquay.



REMUSICA

REMUSICA

19 MAJ 2008

E HËNË

19:30 **Koncert** / Kisha Katolike “Shën Ndou” /

Johannes Fischer, perkusione (Gjermani)

Eugene Ughetti

Frenetic Fantasy Etude

për daulle dhe shirit manjetik

Vinko Globokar

Corporel

për perkusionist dhe trupin e tij

Alvin Lucier

Silver Streetcar for the Orchestra

për triangël të zëruar

Anthony Pateras

Hypnagogics

për mikrotinuj dhe shirit manjetik

Nicolaus A. Huber

Clash music

për çift cimbalësh kineze

Mendi Mengjiqi

Meditim për vibrafon

Vinko Globokar

Toucher

për perkusionist recitator

Javier Alvarez

Temazcal

për marakas dhe shirit manjetik



Johannes Fischer

I lindur më 1981 në Leonberg (Gjermani), ai mori mësimet e para në piano dhe perkusione në moshën 9 vjeçare. Që nga 2001 ai studioi në Universitetin e Muzikës në Freiburg me Prof. Bernhard Wulff, Prof. Tajiro Miyazaki dhe Pascal Pons duke përfunduar studimet diplomike më 2006. Që nga kjo kohë ai i thellon studimet në Freiburg por edhe vazhdon studimet në dirigjim me Prof. Francis Travis si dhe në kompozim me Prof. Dieter Mack. Është fitues i disa çmimeve si perkusionist dhe kompozitor, në mes tjerash fitues i Çmimit të Dytë në Garat Ndërkombëtare në Frankfurt. Me duetin për daulle-perkusion fitoi Çmimin e Parë në Garat Muzikore të Universiteteve Gjermane më 2006. Si solist fitoi Çmimin e parë, çmimin e publikut ndërkaf fitoi edhe tre çmime të tjera në Garat Ndërkombëtare të 56. në ARD në Mynih. Me financimin e Gerd-Bucerus-Scholarship ai qëndroi si “artist në rezidencë” në Universitetin e Kalifornisë në San Diego, ku punoi me Prof. Steven Schick në pranverën e vitit 2007. Fischer ka një agjendë të ngjeshur koncertale si solist dhe si muziktar kamertal me Grupin Perkusionist të Freiburgut, Duetin per Daulle, duetin Apeiron (flaut dhe perkusion), Ansamblin Aventure dhe me Filharmoninë Kamertale Bavareze. Ai ka punuar me kompozitorë dhe dirigjentë të njohur si Peter Eötvös, Harrison Birtwhistle, Klaus Huber, Isabel Mundry, N.A. Huber, Heinz Holliger dhe Pierre Boulez. Fischer ka performuar në festivalet muzikore gjithandej në Azi, Amerikë Veriore dhe në Evropë. Si kompozitor është angazhuar disa herë nga Festivali Muzikor - Crested Bute në SHBA, Akademia e Festivalit në Lucern, Grupi Perkusionit në Freiburg, Junges Klangforum Mitte Europa si dhe nga Muzeu i Louvre-it në Paris në bashkëpunim me Festivalin e Lucernit. Që nga 2006 Johannes Fischer jep mësim për perkusione në Konservatorin e Muzikës në Lugano, Zvicër. Në pranverë të vitit 2008 CD-ja e tij debutante do të lansohet me Oehms Classics me vepra solo nga Pintscher, Lopez-Lopez, Druckman, Globokar dhe Xenakis.



REMUSICA

SI



22 MAJ 2008
E ENJTE

19:30 Koncert / Kisha Katolike “Shën Ndou” /

Kori i Filharmonisë së Kosovës

Rafet RUDI, dirigjent

Johannes Brahms
In stiller Nacht

Olivier Messiaen
O Sacrum Convivium

Mendi Mengjiqi
OEIA

Velislav Zaimov
In modo albanese


Zoltan Kodaj
Matrai Kepek

0 0 0

Franz Liszt
Ave Maria

Rafet Rudi
Afresk Arbëresh III
për soprano, kor, 2 piano, organo, recitator dhe shirit manjetik

CA



KORI I FILHARMONISË SË KOSOVËS

Kori i Filharmonisë së Kosovës është ansambël profesional (me 50 antarë) i cili vazhdon punën e Korit profesional të ish Radio-televizionit të Prishtinës, kor i cili veproi me shumë sukses që nga viti 1980 pikërisht nën drejtimin e dirigjentit aktual të Korit - Rafet Rudit. Me aktivitetin e tij Kori i Filharmonisë gjithashtu vazhdon të kultivojë traditën e këndimit koral që në Kosovë ekziston që nga viti 1945.

Programi i këtij ansambli përfshin vepra të mjeshtërve të vjetër (Morley, Monteverdi, Lasso) e deri te veprat e rëndësishme të literaturës moderne korale. Vend të rëndësishëm në programet e Korit zënë krijimtaria e muzikës së kompozitorëve kosovarë.

Deri më tash ka pasur një sërë prezantimesh të rëndësishme në realizimin e programeve kryesisht vokalo-instrumentale. Në kohën e fundit kanë filluar edhe paraqitjet e këtij ansambli edhe me koncertet *a capella*.


Bashkë me Orkestrën filharmonike të Kosovës me koncertet e tyre të vazhdueshme, paraqet bazë të rëndësishme të jetës muzikore në Kosovë dhe bërthamën e nevojshme në drejtim të formimit të Operës së Kosovës.





23 MAJ 2008

E PREMTE



19:30 **Koncert - Muzikë kamertale** / Kisha Katolike “Shën Ndou” /

Artistët shqiptar

Elife Podvorica, soprano

Luigi Cherubini

Achi, che forse ai miei di

Tommaso Traetta

Ma che vi costa, Signor tutore

Pranvera Hoxha, piano

Blerim Grubi, viola

Benjamin Britten

Elegy for solo viola

Mourice Ravel

Pavana

Lule Elezi, piano

Sihana Badivuku, violinë

Alfred Schnittke

Sonata nr.1

Andante, Allegretto, Largo, Allegretto scherzando

Lejla Pula, piano

Esat Rizvanolli

Rondo rustico

Claude Debussy

Images


I - Reflets dans l'eau

III - Mouvement

VI - Poissons d'or



REMUSICA



24 MAJ 2008

E SHTUNË

19:30 **Koncert** / Atriumi i Bibliotekës Kombëtare /

Kompozitorët dhe interpretët e rinj

Vullnet Tairi

Tri pjesë për flaut solo
"Melodi", "Arabeska", "Monolog"

Lejla Beqiri, flaut

Gerard Meunier

"L'oiseau de lumiere"

Liudmila Ivanova, piano (Bullgari)
Allegro

Valton Beqiri

Kroi i fshatit tonë

Zana Abazi, soprano

Lule Elezi, piano

Mendi Mengjiqi

Kënga

Riad Ymeri, tenor

Agron Shujaku, piano

5 Sergei Prokofiev

Sonata nr.5 Op.38

Allegro tranquillo, Andantino, Un poco allegretto

Ognenka Gerasimovska, piano (Maqedoni)

Luciano Berio

LIED *për klarinet solo*

Blerim Emerllahu, klarinet

Fahri Beqiri

Nata në Dukagjin

Luan Durmishi, tenor

Vinçenc Gjini

Letrat I - Kangët pa ty nuk dijnë të jenë kangë

Zoltan Kodaly

Die Ruine

Okteti +

Arvo Pärt

The Most Holly Mother of God

Sanije Matoshi, mexosoprano

Okteti +

Ergys Pirani

Temë me variazione

Ajet Çekiçi

Kuartet harkor

Kreshnik Aliçkaj

Kuartet harkor / Koha I

Joaquin Rodrigo

Aranguez / Koha II

Denik Prizreni, bariton

Gjulian Bytyqi, Elvis Bytyqi, kitarë

Kushtrim Gashi

5 Pjesë për piano

Neritan Hysa, piano

Drinor Zymberi

Pastorale - *për dy klarineta in B dhe piano.*

Raif Hoxha, klarinet 1

Ilire Avdiu, klarinet 2

Arbnor Krasniqi, piano

String Quartet (Tiranë - Shqipëri)

Nevila Dergjini, Romina Tafaj, Rezarta Peçi, violinë

Estela Jaho, violonçel

REMUSICA

19:30 Koncert / Pallati i Rinisë – Salla e Kuqe /

Orkestra e Filharmonisë - Operës së Kosovës

Baki Jashari, dirigjent
Bostjan Lipovsek, kornë (Slloveni)

Zeqirja Ballata

Pro Memoria 1462
për bariton, recitator, kor dhe ansambël kamertal
Ahmet Dërguti, bariton
Shkelzen Veseli, recitator
Misbah Kaçamaku, piano
Jeta Dumnica, piano
Mojca Sedeu, perkusione
Patris Berisha, perkusione

Wolfgang Amadeus Mozart

Koncert për kornë dhe orkestër No.2 Es-dur KV 417
Allegro maestoso, Andante, Rondo: Allegro
Bostjan Lipovsek, kornë

0 0 0

Rexho Mulliqi

Akuarelet e Prizrenit
për orkestër harkor

Simfonia nr. 1
Koha I - *Allegro*

Orkestra e Filharmonisë së Kosovës

Orkestra e Filharmonisë së Kosovës u themelua pas luftës së fundit në Kosovë në vitin 2000 me iniciativë të disa instrumentistëve të dalluar kosovar. Fillimisht si ansambël harkor e më vonë orkestër kamertale, Filharmonia e Kosovës paraqet padyshim vazhdimësinë e punës së ish Orkestrës Simfonike të Radio-Televizionit të Prishtinës veprimtaria e së cilës u shua me dhunë nga regjimi serb në vitin 1990. Pas konsolidimit të institucioneve shtetërore Filharmonia e Kosovës kalon në mvartësi të Ministrisë së Kulturës e cila financon projektet koncertale dhe aktivitetin e rregullt të këtij institucioni të rëndësishëm muzikor.



Në kuadër të Filharmonisë në vitin 2004 Ministria e Kulturës themelon edhe Operën e Kosovës që reflektohet parasegjithash me formimin e Korit profesional i cili funksionon në realizimin e veprave operistike gjegjësisht atyre vokale-instrumentale por edhe si ansambël i pavarur vokal me programe koncertale a capella. Orkestra e Filharmonisë-Operës së Kosovës realizoi një varg koncertesh simfonike dhe atyre operistike në kuadër të sezoneve koncertale vjetore.Në programet e kësaj orkestre u prezantuan veprat e një mori kompozitorësh botëror dhe atyre shqiptar të të gjitha orientimeve stilistike.Me këtë orkestër koncertuan një varg solistësh instrumental dhe vokal - mes tyre edhe Inva Mula, Tedi Papavrami, Pavel Vernikov, Kevinn Kenner, Florian Stubenvoll, Sihana Badivuku, Antonio Gashi, Venera Kajtazi, Teuta Pllana, Lejla Pula dhe dirigjentët Bahri Çela, Pavle Deshpali, Ermir Krantja, Tadeusz Serafin, Arbër Dhomi, Jetmir Barbullushi, Toshio Yanagisawa, Baki Jashari, Edward Ambartsumyan etj. Në sajë të mungesës së instrumentistëve vendor, për realizimin e koncerteve simfonike Filharmonia-Opera e Kosovës rregullisht angazhon instrumentistë nga orkestrat simotra në Shqipëri dhe Maqedoni.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit



FILHARMONIA - OPERA E KOSOVËS
KOSOVA PHILHARMONY - OPERA



Festivali Ndërkombëtar realizohet nën patronatin e Ministrit të Kulturës, Rinisë, Sportit

Partnerët e Festivalit

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

KFOS

Ambasada e Francës

Goethe Institute

Kuvendi Komunal (Drejtoria për Arsim dhe Kulturë)

Gazeta "Koha Ditore"

RTK, KTV, RTV 21

Filharmonia - Opera e Kosovës

DonAqua

Proreklam

The Pierrot Lunaire Ensemble Wien® is supported by Austrian Cultural Forum Belgrade, Austrian Federal Ministry for European and International Affairs, Arts Division of the Federal Chancellery of Austria, AKM- Austrian Society of lyricists, composers and music publishers, Alban Berg Foundation SKE -social & cultural support of austro mechna, Universal Edition, Doblinger Musikverlag Zeitvertrieb Wien Berlin

Drejtor i Festivalit | **Rafet Rudi**

Bordi i Festivalit | **Baki Jashari, Rafet Rudi, Besa Luzha, Bleta Qerkini**

Themeluese e Festivalit | **Qendra Kosovare për Muzikën e Re - Prishtinë**

Antare e ECPNM -Unionit Europian për Muzikën e Re

Përgjegjës për marrëdhënie me publik | **Bleta Qerkini**

Katalogun e Festivalit | **Baki Jashari**

Incizimet e koncerteve | **Qendra Kosovare për Muzikën e Re**

Koncepti, Disenji & Realizimi i katalogut | **contact@pikastudio.com**

Koncertet mbahen: **Kisha Katolike 'Shën Ndou' / Prishtinë**

Pallati i rinisë - Salla e kuqe

Atriumi i Bibliotekës Kombëtare

Tribuna / Ligjëratat / Puntoritë - **Fakulteti i Arteve dhe ART Qendër/ Prishtinë**

Festival **'ReMusica'**

Rafet RUDI, director

tel. + 377 (0) 44 115-302

address:: Kroi i Bardhe D-V/9

10000 Prishtina KOSOVA

www.remusicafestival.com